



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:229161  
Datë: 03.04.2024  
Numri i dokumentit: 05636634

**AA.nr.434/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditëses L.L., nga M., përfaqësuar nga M. L., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike anulimi i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2387/2021, të datës 04.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.04.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale-Departamenti i Pensioneve, e datës 16.05.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2387/2021, të datës 04.05.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.L. - Mitrovicë dhe Anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës ... dhe vendimi i datës ... dhe paditëses i njihet e drejta në kompensimin retroaktiv në shumën mujore për kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë nga data e parashtrimit të kërkesës 18.12.2020 deri në njohjen e të drejtës në këtë kompensim me këtë vendim gjyqësor të datës 04.05.2023, kurse nga data 05.05.2023 deri më datë 03.05.2028, i njihet e drejta në vazhdim për kompensimin për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë. Në pikën II. Detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensoj në mënyrë retroaktive pagesat mujore të papaguara në emër të kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë nga data 18.12.2020 deri më datë 04.05.2023 dhe atë diferencën prej 225 (dyqind e njëzet e pesë) euro për muaj, diferencë kjo në mes të kompensimit për personat paraplegjik të grupit të parë dhe ati të grupit të dytë (të

cilën kompensim për grupin e dytë paditësja e ka pranuar nga data 18.12.2020), të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Detyrohet e paditura që nga data 05.05.2023 deri më datën 03.05.2028, të kompensoj paditësen në baza mujore, sipas shumëve mujore e cila aplikohet për këtë lloj kompensimi për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, si kompensim më i favorshëm për paditësin. Në pikën III. Pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën II të dispozitivit paditësja i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Në pikën IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësueses Avokaturës Shtetërore, ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të ndryshoj aktgjykimin A.nr.2387/21 të datës 04.05.2023, të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e datës ..., ka refuzuar ankesën e paditëses L.L. në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë.

Paditësja, e pa kënaqur me vendimin e lartcekur, ushtron padi në gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit, me propozim që gjykata pas anulimit të aktit kontestues ti njehë të drejtën në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor më datë 04.05.2023, në prani të përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të palës së paditur, pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditëses, si të bazuar dhe i anulon vendimet e MPMS, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se: Me qëllim të vendosjes meritorie në këtë çështje juridike administrative kjo gjykate duke u bazuar në neni 43.3 të Ligjit për Konflikte Administrative dhe për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje, ka caktuar ekspertizën mjekësore. Me aktin përcjellës të datës 09.03.2023 është dorëzuar ekspertiza në përbërje të ekspertëve Dr.A. G.-pediatër neurolog, Dr.N. A.-fiziatër, Dr.B. K.-neurokirur, në të cilën ekspertizë referohet konstatimi *se paditësja ka parezë të rëndë spastike është e paaftë për jetë të pavarur dhe vetëkujdesje, ka paaftësi psikomotorike 100% e cila është e përhershme, e ka të domosdoshëm përkujdesin nga personi i tretë gjatë 24 orëve. Ekstremitete e sipërme kanë lëvizje të pakontrolluar, altrenativë e kufizuar, por kemi dëmtim 100% të funksionit bazë të duarve. Ekstremitete e poshtme me parezë të theksuar spastike, të kryqëzuara, gjatë mbajtjes në pozitë vertikale nuk është në gjendje të qëndroj në pozitë vertikale, nga pozita shtrirë nuk mund të kaloj në pozitë ulur, nuk i kontrolloj nevojat fiziologjike (ka pampers), nuk din të kërkoj ushqim, nuk është në gjendje të ushqehet dhe të vetë kujdeset, nuk është në gjendje të perceptoj gjendje e rrezikut.*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor Dr.A. G.-pediatër neurolog ka deklaruar *se paditësja hyn në grupin e personave paraplegjik të grupit të parë. Nga data 23.10.2020 kur është shock anaphilactica ka filluar dëmtimi i trurit si pasojë e mungesës së oksigjenit dhe nga kjo periudhë ka filluar të hyj në këtë kategori të paraplegjikëve të grupit të parë.*

Dr. N. A. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbështes deklarin e ekspertit të dhënë si më lartë.

Nga vlerësimi i mendimit të komisionit mjekësor të QKUK-së në ekspertizë mjekësore konstatohet se paditësja hyn në grupin e personave paraplegjik të grupit të parë, ku nga deklarimi i ekspertit konstatohet se me përjetimin e shock anaphilactica ka filluar dëmtimi i trurit si pasojë e mungesës së oksigjenit dhe nga kjo periudhë ka filluar të hyj në këtë kategori të paraplegjikëve të grupit të parë (nga raporti fletë lëshimi Gjykata konstaton periudhën 23.10.2020-09.12.2020 st post shock anaphilactica)) dhe po ashtu nga shkresat e lëndës konstatohet se qysh nga viti 2020 këtu paditësja edhe nga vet e paditura i është njohur e drejta në grupin e dytë të personave paraplegjik dhe tetralegjik, andaj paditësja plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës për persona paraplegjik dhe tetralegjik të grupit të parë ku gjykata kishte parasysh nenin 3 paragrafi 1, neni 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik, si dhe nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik.

Prandaj gjykata konstaton se në bazë të mendimit të dhënë nga Komisioni Mjekësor i QKUK-së sipas ekspertizës mjekësore, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, vërtetohet se paditësja i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës në kompensimin e personave paraplegjik dhe tetralegjik të grupit të parë, i përcaktuar nga neni 3 dhe neni 7 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik dhe mbi këto arsye edhe vendimin kontestues e konstaton si jo të drejtë dhe jo të ligjshëm.

Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me njohjen e të drejtës dhe kompensimin si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi gjykata kishte parasysh kërkesën dhe parashtrimin e saj.

Lidhur me periudhën e vendosjes si në pikën II të dispozitivit u vendos në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik ku përcaktohet :’E drejta në kompensim të përfituesve të këtij ligji, si dhe të kujdestarit personal të tyre, realizohet nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”. Si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik ku përcaktohet: “Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t’i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik”.

Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv Gjykata kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”. Lartësia e shumës së kompensimit u vendos në kuptim të nenit 7.1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetralegjik. Sipas propozimit të paditësit Gjykata ka aprovuar për kompensim diferencën e shumës në mes të

kompensimit për paraplegjik të grupit të parë dhe ati të grupit të dytë të cilin paditësja e ka përfituar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale me anulimin e vendimit të atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, sepse është i përfshirë me të meta esenciale.

Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditëses të nxjerr vendim përmbajtjesorë ashtu siç parashihet me nenet 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti dhe në arsyetim të jepen arsye të plota dhe të qarta, e jo të thirret vetëm në bazat ligjore dhe të përgjithësuara pa u shqyrtuar çështja në mënyrë të argumentuar dhe bindëse për rastin konkret.

Kolegji, po ashtu vlerëson se të gjeturat e Gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe të bazuara sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, kur vendimin e saj e mbështet në ekspertizën mjekësore të QKUK-së të datës 09.03.2023 e përpiluar nga tre mjekë specialist, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësen dhe dokumentacionin mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, kanë ardhur në përfundimin se pacientja ka parezë të rëndë spastike është e paaftë për jetë të pavarur dhe vetëkujdesje, ka paaftësi psikomotorike 100% e cila është e përhershme, e ka të domosdoshëm përkujdesin nga personi i tretë gjatë 24 orëve. Ekstremitete e sipërme kanë lëvizje të pakontrolluar, alternativë e kufizuar, por kemi dëmtim 100% të funksionit bazë të duarve. Ekstremitete e poshtme me parezë të theksuar spastike, të kryqëzuara, gjatë mbajtjes në pozitë vertikale nuk është në gjendje të qëndroj në pozitë vertikale, nga pozita shtrirë nuk mund të kaloj në pozitë ulur, nuk i kontrollon nevojat fiziologjike (ka pampers), nuk din të kërkoj ushqim, nuk është në gjendje të ushqehet dhe të vetë kujdeset, nuk është në gjendje të perceptoj gjendje e rrezikut. Po ashtu eksperti imit gjyqësor Dr.A. G.-pediatër neurolog ka deklaruar se paditësja hyn në grupin e personave paraplegjik të grupit të parë. Nga data 23.10.2020 kur është shock anafilactica ka filluar dëmtimi i trurit si pasojë e mungesës së oksigjenit dhe nga kjo periudhë ka filluar të hyj në këtë kategori të paraplegjikeve të grupit të parë, e të cilin konkuldin kanë vazhduar të mbështesin edhe në seancën e shqyrtimit kryesor.

Nga kjo gjendje e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është vendosur kur paditëses, i është njohur e drejta në pension për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, dhe atë për pesë vite, si në dispozitivin e ankimuar. Andaj duke u bazuar në nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-067 me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar

drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, dhe se arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton paditësi, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit të çështjes nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, por aktgjykimin e mbështet në provat e paditësit, duke mos marrë parasysh fare faktin se paditësja nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme, duke kuptuar se nuk e ka arsyetuar paafësinë e tij, për çka do të thotë se nuk ka dokumentacion mjekësor që do ta dëshmon të kundërtën. Gjithashtu, kjo gjykatë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore. Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, përkatësisht, Ligji nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 3, paragrafi 1.2, neni 7, dhe neni 8. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**AA.nr.434/2023, me datë 03.04.2024**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Delushe Halimi**